

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 2942 Rep.

Nr. 1108 Kol



KONTRATE PER SHKEMBIMIN E AKSIONEVE DHE KUOTAVE

Sot me date 11.05.2006, perpara meje Noteres, Mimoza Sadushi, me zyre noterie ne Rr. Vaso Pasha, Tirane, lidhet kjo Kontrate per Shitblerje Aksionesh (ketej e tutje referuar "Kontrata"),

ndermjet

- **Z. JULIEN ROCHE**, shtetas francez, lindur me 02.07.1954, ne Bourg-en-Bresse, France, i biri i Marius dhe Marie-Therese, banues ne adresen: Fshati Turistik, Golem, Kavaje, mbajtes i pasaportes nr. 05RE405504
- **Z. MARSEL SKENDAJ**, i biri i Zagollit dhe i Lushes, shtetas shqiptar, lindur ne Tepelene, me 06.11.1999, banues ne Tirane, Rr. Dervish Hima, nr. 1, kati 10 mbajtes i pasaportes nr. 0165026; dhe
- **Z. ALEKSANDER FRANGAJ**, i biri i Vasilit i Gjystes, qytetar shqiptar, lindur ne Lezhe, me 4.10.1968, banues ne Tirane me adrese ne Rr. Dervish Hima nr. 1, kati 9, pasaporte nr. 0011369.

KUSHTET PARAPRAKE

- Z. Marsel Skendaj, Z. Aleksander Frangaj dhe Z. Julien Roche jane aksioneret qe zoterojne teresisht kapitalin e MEDIA 7 SHA (me poshte e quajtur "Media 7"), qe eshte nje shoqeri anonime e krijuar sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar me vendimin nr. 25707, date 30.04.2001 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, me seli ne adresen Rr. Dervish Hima nr. 1, me kapital themeltar 2,000,000 (dymilion) leke, i ndare ne 2,000 (dymije) aksione nominative me vlere nominale 1,000 (njemije) leke secili, i nenshkruar dhe i shlyer teresisht nga aksioneret ne raportet: (i) aksioneri Marsel Skende, 770 (shtateqind e shtatedhjete) aksione; (ii) aksioneri Julien Roche, 770 (shtateqind e shtatedhjete) aksione; dhe (iii) aksioneri Aleksander Frangaj, 460 (katerqind e gjashtedhjete) aksione.
- Z. Marsel Skendaj, Z. Aleksander Frangaj dhe Z. Julien Roche jane ortaket qe zoterojne teresisht kapitalin e MEDIA 5 SHPK (me poshte e quajtur "Media 5"), qe eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e krijuar sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar me vendimin nr.

23669, date 26.04.2000 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, me seli ne adresen Blvd Deshmoret e Kombit, 2 kullat binjake, kulla e pare, kati 10, Tirane, me kapital themeltar 100,000 (njqindmije) leke, i ndare ne 100 (njqind) pjese, me vlere nominale 1000 (njemije) leke secila, i nenshkuar dhe i shlyer teresisht nga ortaket ne raportet: (i) ortaku Marsel Skened, 41.5 (dzyetenje pike pese) pjese; (ii) ortaku Julien Roche, 41.5 (dzyetenje pike pese) pjese; dhe (iii) ortaku Aleksander Frangaj, 17 (shtatembedhjete) pjese;

Z. Marsel Skendaj, Z. Aleksander Frangaj dhe Z. Julien Roche jane aksioneret qe zoterojne teresisht kapitalin e Media 6 Sh.A. (me poshte "Media 6") e cila eshte nje shoqeri anonime e krijuar sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise, qe ushtron aktivitetin e saj ne fushen e transmetimeve televizive, aktiviteti ekskluziv i te ciles eshte Televizioni Klan, me kapital themeltar 180.000.000 (njqind e tetedhjete milione) leke, i ndare ne 180.000 (njqind e tetedhjete mije) aksione nominative me vlere nominale 1.000 (njemije) leke secili, teresisht i nenshkuar dhe i shlyer nga aksioneret ne raportet: (i) aksioneri Marsel Skendaj, 60.000 (gjashtedhjete mije) aksione; (ii) aksioneri Aleksander Frangaj, 60.000 (gjashtedhjete mije) aksione; dhe (iii) aksioneri Julien Roche, 60.000 (gjashtedhjete mije) aksione.


- Ne vijim te: (i) neneve 1, 2 dhe 3 te Memorandumit te Mirekuptimit te nenshkuar midis Z. Aleksander Frangaj, Z. Marsel Skendaj, Z. Julien Roche, Znj. Alba Gina, Z. Ervin Gjikota dhe Media 6 me date 11.05.2006 (me poshte i quajtur "Memorandumi"); (ii) dhe te Kontrates per Shit-Blerje Aksionesh te lidhur mes Z. Aleksander Frangaj, Z. Marsel Skendaj dhe Z. Julien Roche ne cilesine e bleresve dhe Media 6 ne cilesine e Shitesit, me date 11.5.2006, me nr. 234/rep., nr. 137 kol.; Z. Aleksander Frangaj, Z. Marsel Skendaj dhe Z. Julien Roche lidhin kete Kontrate per te percaktuar ne menyre te detajuar kushtet dhe afatet per realizimin e transakcioneve te pershkuara ne paragrafin (F) te Hyrjes se Memorandumit dhe ne nenet 2 e 3 te Memorandumit.

MEQE EKZISTOJNE KUSHTET PARAPRAKE,
PALET BIEN DAKORT PERSA ME POSHTE:

Neni 1 – Kushtet Paraprake dhe Shtojcat

Kushtet paraprake te mesiperme dhe Shtojcat bashkangjitur jane pjese perberese e kesaj Kontrate.

Neni 2 – Objekti i Kontrates



2.1. Ne perputhje me kushtet e kesaj Kontrate, Z. Marsel Skendaj shkemben pronesine e tij mbi 6.000 (gjashte mije) aksione qe zoteron ne kapitalin e Media 6 me pronesine e Z. Aleksander Frangaj mbi:

- (i) 230 (dyqind e tridhjetete) aksione qe Z. Aleksander Frangaj zoteron ne kapitalin e shoqerise Media 7, qe perbejne 11,5% te te gjithe kapitalit te shoqerise Media 7;
- (ii) 8.5 (tete pike pese) pjese qe Z. Aleksander Frangaj zotero ne kapitalin e shoqerise Media 5, qe perbejne 8,5% te te gjithe kapitalit te shoqerise Media 5,
- (iii) 7.8 (shtate pike tete) aksione qe Z. Aleksander Frangaj zoteron ne kapitalin e shoqerise SAT +, qe perbejne 3.5% te te gjithe kapitalit te shoqerise SAT +.

2.2 Ne perputhje me kushtet e kesaj Kontrate, Z. Julien Roche shkemben pronesine e tij mbi 6.000 (gjashte mije) aksione qe zoteron ne kapitalin e Media 6 me pronesine e Z. Aleksander Frangaj mbi:

- (i) 230 (dyqind e tridhjetete) aksione qe Z. Aleksander Frangaj zoteron ne kapitalin e shoqerise Media 7, qe perbejne 11,5% te te gjithe kapitalit te shoqerise Media 7;
- (ii) 8.5 (tete pike pese) pjese qe Z. Aleksander Frangaj zotero ne kapitalin e shoqerise Media 5, qe perbejne 8,5% te te gjithe kapitalit te shoqerise Media 5,
- (iii) 7.8 (shtate pike tete) aksione qe Z. Aleksander Frangaj zoteron ne kapitalin e shoqerise SAT +, qe perbejne 3.5% te te gjithe kapitalit te shoqerise SAT +.

2.2. Me vendimin e saj date 11.5.2006, Asambleja e shoqerise Media 6 ka miratuar transferimin e aksioneve te kesaj shoqerise nga Marsel Skendaj dhe Julien Roche tek Z. Aleksander Frangaj. Me nenshkrimin e kesaj kontrate shkembimi Z. Aleksander Frangaj do te zoteroje 72,000 aksione te barabarta me 40% te aksioneve te Shoqerise Media 6.

2.3. Ne perputhje me nenin 20.2 te Statutit te shoqerise Sat +, aksionet jane lirisht te transferueshme midis aksionereve e nuk kerkohet miratim paraprak nga aksioneret e tjere. Me nenshkrimin e kesaj Kontrate shkembimi Z. Julien Roche do te zoteroje 15% te kapitalit aksioner te shoqerise Sat+, Z. Marsel Skendaj do te zoteroje 15% te kapitalit aksioner te shoqerise Sat + dhe Z. Aleksander Frangaj do te zoteroje 3.33 % te kapitalit aksioner te shoqerise Sat +.

2.4. Transferimi i aksioneve te shoqerise Media 7 eshte miratuar nga vendimin perkates te asamblese se aksionereve date 11.5.2006. Me nenshkrimin e kesaj Kontrate Shkembimi, aksionere te Shoqerise Media 7, me nga 50% te aksioneve secili do te mbeten vetem Z. Marsel Skendaj dhe Z. Julien Roche.

2.5. Transferimi i pjeseve te kapitalit ne shoqerine Media 5 eshte miratuar me vendimin e asamblese date 11.5.2006. Me nenshkrimin e kesaj Kontrate Shkembimi ortake te shoqerise Media 5 me nje kuote prej 50% te kapitalit secili do te jene vetem Z. Marsel Skendaj dhe Z. Julien Roche.

Neni 3 – Deklarimet dhe Garancite e Paleve

3.1 Ne daten e nenshkrimit te kesaj Kontrate, palet nepermjet ketij akti deklarojne dhe garantojne se:



- a) Secili prej paleve eshte i vetmi pronar i Aksioneve dhe pjeseve te kapitalit te cituara ne Kushtet Paraprake;
Respektivisht, aksionet dhe pjeset e kapitalit jane emetuar e nenshkruar ne menyre te rregullt dhe jane shlyer plotesisht;
Aksionet dhe pjeset e kapitalit jane te lira nga çdo barre apo detyrim dhe secili prej Paleve ka te drejta te plota per te shitur dhe transferuar aksionet dhe pjeset e kapitalit ne perputhje me kushtet e kesaj Kontrate; dhe
Çdo deklarim e garanci e bere ne emer te paleve ne lidhje me shkembimin e aksioneve dhe pjeseve te kapitalit objekt i kesaj kontrate do te konsiderohet si e bere veçmas dhe bashkarisht prej tyre.

3.2 Secili prej Paleve angazhohet, premton dhe garanton tjetrin se me nenshkrimin e kesaj Kontrate dhe ne momentin e transferimit te aksioneve ne regjistrin e aksionereve te Shoqerise:

- a) i kalon pales tjetër respektivisht titull ligjor te plote dhe te parevokueshem mbi Aksionet dhe/dhe ose pjeset e kapitalit; dhe se
b) Secila prej paleve qe do te fitoje te drejten e pronesise, do te kete te drejten per te perfituar çdo dividend dhe te gjitha te drejtat qe lidhen me Alsioent ose kuotat perkatese. Palet deklarojne se nuk do te kerkojne asnje asnje dividend te prapambetur te pashperndare apo te pa marre ne lidhje me aksionet dhe/ose pjeset e kapitalit qe po shkembejne .

3.3. Me nenshkrimin e kesaj kontrate:

- Z. Aleksander Frangaj jep doreheqjen shprehimisht nga detyra e anetarit te keshillit mbikqyres te shoqerise Media 7 sh.a.;
- Z. Marsel Skende jep doreheqjen shprehimisht nga detyra e anetrit te keshillit mbikqyres te shoqerise Media 6 Sh.a.;
- Z. Julien Roche jep doreheqjen shprehimisht nga detyra e anetrit te keshillit mbikqyres te shoqerise Media 6 Sh.a.

Neni 4- Trashegimtaret apo perfituesit nga ndonje kalim apo cedim

Kjo Kontrate do te jete detyruese apo ne perfitim te Paleve dhe trashegimtareve apo perfituesve te tyre per shkak te ndonje kalimi apo cedimi.

Neni 5 - Shpenzimet dhe Taksat

Te gjitha shpenzimet ligjore te noterise lidhur me kete Kontrate do te perballohen ne menyre te barabarte nga paplet e kesaj Kontrate.

Neni 6 - Njoftimet

Te gjitha njoftimet apo komunikimet e tjera te kerkuara ose qe duhet te jipen sipas kesaj Kontrate do te behen me shkrim dhe do te konsiderohen se jane dhene nese i dorezohen Paleve personalisht apo dergohen me faks (me konfirmim), postohen me poste

rekomande (me kthim pergjigje) ne adresat e meposhtme apo ne ato adresa qe mund te ndryshohen dhe njoftohen me shkrim:

per Z. Marsel Skendaj: Ada Holding, Rr. Dervish Hima nr. 1 Tirane
per Z. Julien Roche: Fshati Turistik, Golem, Kavaje
per Z. Aleksander Frangaj: Rr. Dervish Hima nr. 1, kati 9, Tirane.

Neni 7 – Legjislacioni i zbatueshem

Kjo Kontrate dhe te drejtat e detyrimet e Paleve do te rregullohen dhe nga legjislacioni shqiptar.

Neni 8 – Zgjidhja e mosmarveshjeve


Ne rast mosmarveshje midis Paleve lidhur me interpretimin, ekzekutimin, shkeljen, perfundimin apo zbatueshmerine e kesaj Kontrate dhe Shtojcave perkatese, Palet do te takohen dhe perpiqen ne mirebesim te zgjidhin sa me shpejt qe te jete e mundur mosmarveshjen ne fjale. Nese kjo mosmarveshje nuk mund te zgjidhet me muktupim, gjykata kompetente per zgjidhjen e mosmarveshjeve do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane, vendimet e se ciles jane te ankimeshme sipas dispozitave te Kodit te Procedures Civile te Republikes se Shqiperise.


Neni 9 – Te ndryshme


- 9.1. Kjo Kontrate e shkruar perben te gjitha marveshjen ndermjet Paleve dhe zevendeson te gjitha marveshjet e meparshme verbale apo me shkrim dhe çdo komunikim tjeter te meparshem ndermjet Paleve qe lidhet me objektin e kesaj Kontrate.
- 9.2. Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne kete Kontrate, çdo ndryshim i kesaj Kontrate mund te behet vetem me marveshje me shkrim, nenshkruar nga te dyja Palet.
- 9.3. Palet pranojne se kushtet dhe afatet e kesaj Kontrate jane konfidenciale dhe nuk mund t'i behen te ditura paleve te treta, perveç rasteve kur kerkohet nga legjislacioni ne fuqi.
- 9.4. Kjo Kontrate nenshkruhet ne 6 (gjashte) kopje origjinale ne shqip.
- 9.5. Shpenzimet noteriale per hartimin e kesaj kontrate do te paguhen prej paleve proporcionalsiht, ndersa secila pale paguan avokatin e tij.
- 9.6. Drejtoret e seciles prej shoqerive aksionere, aksionet e te cilave jane objekt i kesaj kontrate shkembimi, Media 6, Media 7, SAT +, dhe Administratori i Media 5, duhet te marrin te gjitha masat per te kryer depozitimi e kesaj kontrate prane Regjistrat Tregtar dhe/ose regjistrave te aksioneve nese mbahen prej shoqerive.


Persa me siper, Palet deklarojne, ne prani edhe te perkthyeses se kjo Kontrate eshte ne perputhje te plote me vullnetin e tyre, dhe e nenshkruajne ate ne pranine time, Noteres, ne daten e sotme, me vullnetin e tyre te plote e te lire, dhe une Noterja vertetoj nenshkrimet e tyre sipas ligjit ne fuqi sot me date 11.5.2006.


PALET


Marsel Skendaj


Julien Roche


Noterja
Mimosa Sadushi


Aleksander Frangaj


Perkthyeses